

# **MATTEO MANDALÀ DHE ALBANOLOGJIA SOT**

*Në 60-vjetorin e lindjes*

Me kujdesin e / A cura di

Francesco Altimari  
Gëzim Gurga  
Shaban Sinani

Fast print  
Tiranë 2018

## PASQYRA E LËNDËS

Tabula gratulatoria	3
Francesco Altimari <i>Matteo Mandalà dhe albanologjia sot</i>	9
Gëzim Gurga <i>Bibliografi e botimeve shkencore të Matteo Mandalasë</i>	17
Gjilda Alimhilli Prendushi <i>Analizë dydimensionale gjeometrike e llojeve aspektore</i>	29
Lindita Aliu Tahirri <i>Bota që do të génjehet dhe lexuesi që do të dyshojë</i>	45
Benedetta Baldi & Leonardo M. Savoia <i>Variation in the neuter morpho-syntax in Arbëresh dialects</i>	49
Anton Nikë Berisha <i>Dorëshkrimi i Kieutit një gurthemel i traditës letrare gojore dhe të shkruar arbëreshe</i>	65
Walter Breu <i>Das Italoalbanische zwischen balkanischem Erbe und kontaktbedingter Entwicklung</i>	77
Carlo Spartaco Capogreco <i>L'internamento degli ebrei e la geografia della Shoah in Italia durante la Seconda guerra mondiale</i>	97
Giovanni Cimbalo <i>Le politiche demografiche in Albania e Kosovo</i>	119
Floresha Dado <i>Parimi i "rindërtimit" - boshti metodologjik në studimet e Mandalasë</i>	127
Mario de Matteis <i>Was Münzen und Geldscheine über die kulturhistorische Geschichte Albaniens erzählen könnten</i>	139
Bardhyl Demiraj <i>Rishtarë arbëreshë në Kolegjin Urban</i>	165

## RISHTARË ARBËRESHË NË KOLEGJIN URBAN

*<Fallim nddersë t'Arbit,  
qgiacu t'culluam farëmirit>*

(Chetta: *Tesoro* 1777, § 250)

Në këtë punim që ia përkushtoj kolegut, mikut dhe vërsnikut tim të shtrenjtë Matteo Madalà kam përbledhur e tematizuar sado thukët do ‘shëname’ të nxjerra dikur ashtu kalimthi gjatë kërkimeve në Arkivin dhe Bibliotekën e Kolegit Urban (ACU) si edhe në Arkivin Historik të Propaganda Fide-s (Romë, 24-30 tetor 2015 – ASPF). I theksoj në thonjëza këto ‘shëname’ jo thjesht dhe vetëm për t'i tërhequr qysh në fillim vëmendjen lexuesit sqimatar në paplotësinë që bashkëbart titulli dhe përbajtja e këtij shkrimi, por edhe – madje sidomos (!) – në dëshirën e mirë me iu bashkuar herët a vonë asaj përsiatjeje të mprehtë që kanë shtruar vite më parë për diskutim në diskursin intelektual-albanologjik shqiptar si gjithherë së bashku Jubilari ynë dhe Francesco Altimari.

Prashtu bëjmë fjalë për periudhën e ashtuquajtur *Rilindje para Rilindjes*, ashtu siç e kanë pagëzuar këta të dy studiues, e cila – parë nga perspektiva e studimit historik-albanologjik – përkon në kohë jo rastësish me ndryshimin e paradigmës që përjetoi mendimi intelektual shqiptar prej gjysmës së parë të shek. XVIII, shi kur në arealin kulturor arbëresh u përfshuan dy qendra të formimit të mirëfilltë intelektual-fetar, siç ishin *Collegio Corsini* në San Benedetto Ulano (1732, më pas *Collegio Sant' Adriano* në S. Demetrio Corone), i themeluar falë mundit të vëllezërve Rodotà dhe *Seminario Italo-Greco* në Palermo (1734, më pas *Seminario Italo-Albanese* në Horën e Arbëreshëve të Sicilisë), falë ngulmit të At Gjergj Guxetës (= Padre Giorgio Guzzetta), i mirënjojur si *Apostolo degli albanesi di Sicilia*.

A lejohemi tash të zgjasim e zgjerojmë sadopak radiusin kohor dhe hapësinor të kësaj periudhe të parëlemë e bashkë me të edhe të diskursit përkatës tej hapësirës arbërishtfolëse, duke rrokur kështu edhe pjesë are-

alesh kulturore në dheun amë, bash duke e shtyrë atë në kohë deri diku para fillimeve të periudhës së Përlindjes Shqiptare, ase siç jemi mësuar ta quajmë sot Rilindja Kombëtare Shqiptare, parë kjo si lëvizje kulturore-ideologjike dhe politike-nacioniste mbarëshqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIX deri në fillimet e shek. XX? Janë këto pyetje mbi pyetje, në dukje paksa të vështira për t'u përtypur, por assesi provokuese, madje akëcilit studiues, sidomos asi me gjak shqiptari den-baba-den, sa të shpërshur aq edhe të paprishur, ia do zemra e shpirti t'i japë sipas kohës, vendit dhe rastit përgjigje (vetëm ?) pozitive. Këtë rrëthanë ka përsiatur dikur Jubilar i ynë dora vetë kur shkruan në letër të bardhë mbi: "l'existenza di rapporti culturali fra gli ambienti arbereschi e schipetari già agli albori del sec. XVIII..." (Mandalà 1994). E këtë ia kërkon shpirti dhe zemra sigurisht edhe shkruesit të këtyre radhëve, veçse ja që ashtu ia kanë prerë vejetret fatin: të kërkojë e rrëmihë fakte shtesë; e kur ato s'i gjen, të heqë dorë nga tundimi qoftë edhe përkohësisht; ndërsa kur i qëmton sado me pakicë, atëherë të rrekjet me rindërtuar *idealiter* realitetë kulturore-gjuhësore, duke i tumirur ose vënë ato në provë me argumente kauzale shtesë, qofshin këto pozitive ose negative.

Asgjëmangut, në rindërtimin e realitetit në fjalë, parë ky si diskurs albanologjik brenda dhe midis arealesh kulturore, vrasim mendjen së pari me njojur dhe hetuar një mjedis potencial të shkëmbimit të informacionit, që pritej të realizohej atëbotë më fort nëpërmjet qarkullimit të librit (shqip) sikurse, madje sidomos, falë aktivitetit epistolar, thënë ndryshe përmes një komunikimi të ndërmjetshëm midis këtyre rrëtheve intelektuale shqipfolëse.<sup>1</sup> Gjithsesi intensiteti i këtij komunikimi ka gjasë të mund të rritet dukshëm, nëse arrijmë të fiksojmë bindshëm edhe një mjedis real si vendndodhje a vendngjarje që do të motivonte dhe përkujdeste kohë pas kohe dhe rast pas rasti edhe një ndërkëmbim të pandërmjetshëm të informacionit midis anëtarëve të ndryshëm të këtyre rrëtheve, ku ata – e pse jo! – njiheshin personalisht, thyenin bukën bashkë e që këtej lidhni miqësi të thekura, jepnin fjalën besa-besë etj., etj., etj. Parë nga kjo perspektivë nuk jemi larg së vërtetës, në rast se për periudhën në fjalë i mbajmë sytë hapur e veshët pipëz drejt Romës si qendër kryesore urbane e nyjëlidhëse edhe sa i përket ndërkëmbimit të drejtpërdrejtë të informacionit midis arcaleve kulturore në diskursin intelektual-albanologjik bashkëkohor.

Përザgjedhja e kësaj alternative shtesë në rindërtimin e këtij diskursi përgjatë kësaj periudhe të parëlemë është joshëse për shumëkënd që është i dëshiruar t'i japë përgjigje pozitive pyetjes lart, anipse argumenti pozitiv mund të tingëllojë jo gjithherë si shkencor i thekur. Këtë rrëthanë lejohemi ta sendërtojmë me një shembull të përshkruar dikur nga vetë Jubilari ynë (2007 225vv.), kur rrëmih e zbulon në ‘Thesarin’ që na ka lënë trashëgim Nikollë Keta (= Nicolò Chetta), se sa dhe si i paska hyrë në zemër dikur Apostullit tonë kryebariu i porsazgjedhur i Arqipeshkëvisë së Shkupit, Gjon P. Nikollë Kazazi dora vetë, kur bënë parjen në Romë, aq sa kishte porositur enkas një piktor t'i bënte një portret për ta pasur gjithherë pranë në ambientet e seminarit. Këtë ndodhi nuk e lë pa regjistruar vetë Keta, kur shkruan se:

“In Seminario abbiam un ritratto con quest’ elogio: Joannes Battista Nicolovich Casasi Scuporum, seu Scopiensis, et totius regni Serviæ administrator, nec non visitator apostolicus in regno Bulgariae, genere Albanensis, natus Jacovæ in Servia, consacratus Romæ 29 settembre 1743. Ætatis suo ann. 42 prië sciùmë vièt [= urim: “për shumë vjet!” – B.D.]. In Roma egli divenne amico del p[adre] Giorgio Guzzetta, che fe fare il suddetto ritratto.”<sup>2</sup>

Ani, le të urojmë me këtë rast edhe Jubilarin tonë me fjalët e patriotit të vet: *Prië sciùmë vièt!*, duke shtuar njëherësh se, po të ecim në këtë hulli ngjërojmë e gëzojmë edhe argumente shkencore të tapinosura, siç është p.sh. rasti me revanshin e vetë Kazazit ndaj Apostullit tonë albanolog, ase më saktë Albanologut tonë apostull, bash kur i bën me dijë ‘zbulimin e madh’, librin e adashit të vet, birit të Bdekës dora vetë, madje duke i dhuruar atij si fakte mbushamendëse do specimina autentike prej “Mesharit” siç ishin kolofoni dhe pjesë nga ceremonia e martesës.<sup>3</sup> Në Romë vijmë,

<sup>2</sup> Përkthimi shqip i këtij pasazhi italisht-latinisht: „Në Seminar kemi një portret me këtë laudatio: Gjon Pagëzuesi Nikollë Kazazi administrator i Shkupianëve apo i Shkupit dhe i gjithë Mbretërisë së Serbisë, si edhe Visitor Apostolik në Mbretërinë e Bullgarisë, me origjinë shqiptare, i lindur në Gjakovë në Serbi, i shuguruar [arqipeshkëv – B.D.] në Romë, më 29 shtator 1743. Mosha e tij, 42 vjeç: *prië scimùë vièt* [= “për shumë vjet!” – B.D.]. Në Romë ai u bë mik i Át Gjergj Guxetës, i cili porositi të bëhet portreti i përmendur.“ Shih më hollësish këtë kumtim të Ketës në kontekstin përkatës në Nicolo Chetta: *Tesoro di notizie su de' Macedoni*, Introduzione di Matteo Mandala, Trascrizione di Giuseppe Fucarino, Helix Media Editore, Palermo-Contessa Entellina, 2002 f. 508-509 [= Mandala 2007 226].

<sup>3</sup> Demiraj 2015 65vv.; 2016 87vv.

shohim dhe fitojmë edhe argumente pozitive kauzale me bollëk, siç janë p.sh. risitë në kodin alfabetik në botimet shqip, ashtu siç i mëtojnë dhe i ndajnë së bashku dita me ditë Gjon P. Nikollë Kazazi me Zef Skironë (= Joseph Schirò – prosenior)<sup>4</sup> etj.

\* \* \*

Në rindërtimin e një arketipi gjithëpërfsirës të diskursit intelektual-albanologjik për këtë periudhë shpresojmë gjithash tu të ndihmojë sadopak si opsjon gjithherë i hapur hetimi i ndërkëmbimit potencial të informacionit në disa vatra të formimit intelektual-fetar, që gjëllinin atëbotë e në vazhdimësi po në Romë e ku sipas kohës e rastit vinin për të nxënë dije e për t'u bërë barinj shpirtorë rishtarë të trevave të ndryshme shqipfolëse. I tillë ishte Kolegji Urban (= *Collegio Urbano*, Romë, 1627-) në regjistrat e të cilit ngjerojmë përpos *alunëve* që vinin nga hapësira shqipfolëse në Ballkan edhe do emra rishtarësh arbëreshë. Këta emra i kemi rrokur në vijim, duke i dhënë kështu formë e kuptim edhe këtij shkrimi nismëtar, përkatësisht titullit të tij, në të cilin përdorimi fatlum i pashquarsisë kumton njëherësh, që nuk mëtojmë assesi vjelje ballore.

Asgjëmangut prania e rishtarëve arbëreshë në Kolegin Urban (Romë, 1627-) mund të duket a tingëllojë në sytë e veshët tanë a) sa e zakonshme, meqë ky kolegj ngërthente në radiusin e destinacionit të tij edhe Kishat Katolike Lindore;<sup>5</sup> b) aq edhe e pazakonshme, meqë jo larg tij jeste motmoti edhe Kolegji Grek (= *Collegio Greco*, Romë, 1576-),<sup>6</sup> i cili gjan të jetë frekuentuar rregullisht prej rishtarëve arbëreshë, madje edhe pasi u ngriten enkas kolegjet e tyre në San Benedetto Ulano dhe Palermo (sh. më lart).<sup>7</sup> Ishte pikërisht kjo rrëthanë e dytë që nxiti mëdyshje te shkruesi i këtyre radhëve gjatë kërkimeve të dikurshme në Arkivin dhe Bibliotekën e Kolegit Urban (sh. më lart), andaj u mjaftua vetëm me do ‘shënime’ të rastit për gjithë-gjithë tetë rishtarë arbëreshë, të cilët janë radhitur poshtë sipas kronologjisë së pranimit të tyre në kolegj, sa vijon:

#### 1. <Giorgio Matranga> (= /Gjergj Matranga/)

E ndeshim këtë emër në regjistrin kryesor të kolegit (ACU RNCAPF I 262) si rishtar që ka përfituar bursën ‘Albani’. Skeda e tij është plotësuar

<sup>4</sup> Demiraj 2015 129v.; 2016 163v.

<sup>5</sup> Sh. ndër të tjera Jezernik 1971, 1973, 1975; Demiraj 2017 90vv.

<sup>6</sup> Hollësishët në bashkëlidhje me tematikën tonë Raques 1985 42vv.

<sup>7</sup> Hollësishët në bashkëlidhje me tematikën tonë Altimari 1985.

prej dy duarsh të ndryshme, ndër të cilat e para kumton rrethanat e ardhjes dhe të regjistrimit të tij në kolegj, ndërsa e dyta vijon me përfundimin e suksesshëm dhe rrethanat e largimit të tij nga kolegji, si më poshtë:

“[Bursa] Albani / Giorgio figlio di Antonino Matranga e Giovanna Coniugi Cattolici nato nella [/Diocesi di Monreale] Piana delli Greci in Sicilia, Battezzato nella Chiesa Parrocchiale di S. Demetrio in età di 7. anni portato dall’Arciu.<sup>o</sup> di Scleucia, Italo Greco, suo zio, entrò in Collegio p[er] ord[in]e di sua S[antit]à li 5: d 8bre 1718: , e fù uestito li p[ri]mo di 9bre. Inseguente, non sa leggere ne scriuere, mà mostra buonissima Indole. Fù cresimato dà Mons.<sup>e</sup> Ferrini Vicegerente li 22. Xbre 1720. Prestò li soliti giuramenti la mattina dellì 30.11.1725. [xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx]  
[xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx]

[xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx] [dora e dytë në dsh. – B.D.] A di 8. Giunn[i]o 1735 partì dal Collegio co[n] licenza della S. Co[n] greg[atio]ne, hauendo anticipato di tre mesi la sua partenza à cagione di una sua indisposi[tio]ne; fù dottorato in Filosofia, e Teologia li 11 Xmbre 1734. Hauea della capacità; mà studiaua lentamente, nell’osserua[n]za fù esatto, era di ottimi costumi, pratico nelle ceremonie sacre; li furono dati p[er] Viatico, Vestiario e deuotioni scudi 35; Partì senza ordinanzi, perche no[n] sapeua la lingua greca essendo uenuto da ragazzo in Collegio, bensi cercò più uolte alla S. Co[n]greg[atio]ne mutare il rito nel latino, ma no[n] hebbe effetto, e però q[uan]do sarà pratico nella lingua si ordinerá ~”

Prashtu ky regjistrim na kumton ndër të tjera, se Gjergji ynë paska lindur në Horë të Arbëreshëve (Dioqeza e Monreale-s), me prindër Antonino dhe Xhovana Matrëngën e na qenka pagëzuar po aty në Kishën e Shën Mitrit. Paska hyrë në kolegj më 5 tetor 1718, i regjistruar si italo-grek [= italo-arbëresh - B.D.] me bursën ‘Albani’, një bursë kjo e akorduar pas gjase personalisht prej Papë Klementit XI dora vetë edhe pér këtë rishtar në moshë njomake, d.m.th. me moshë jo të zakonshme (7 vjeç) e kur s’kishte mësuar as shkrim e këndim. Andaj edhe në fillim ishte marrë si dëgjues.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Raste të këtilla, kur autoritetit të Kongregacionit i duhej të bënte ‘një vesh shurdh e një sy qorr’, na shfaqen jo rrallë në dokumentacionin arkivor të kohës. (sh. edhe Jezernik 1972 287v.) I tillë është rasti me një carrok po 7 vjeç i fisit Albani, prej të cilit rridhte – dale, dale ! – edhe Papa ynë, Klementi XI (= Papë Shqiptari). Veçse

Në Kolegj e shoqëron i ungji që ishte njëherësh ipeshkëv i <Scleuia-s>. Aty merr edhe sakramentin e Krezmimit më 22 dhjetor 1720, ndërsa betimin e rishtarit e kryen pesë vjet më vonë, më 30 nëntor 1725.

Nga dora e dytë në regjistër mësojmë se si ky Gjergji ynë vijon studimet edhe 10 vjet të tjera, deri më 8 qershor 1735 kur largohet nga kolegji, pasi ka doktoruar në filozofi dhe teologji. Mësojmë gjithashtu se nise: për në dioqezën e vet pa marrë urdhëresat e ushtrimit të detyrës së bariu: shpirtëror, meqë nuk ia thekte ende në greqisht. Ishte larguar i vogël nga vendlindja, ku greqishtja ngjërohej me sa duket vetëm gjatë liturgjisë në kishë, ndërsa në Kolegin Urban përdorej italishtja dhe latinishtja. Së fundi mësojmë se edhe kërkesa e tij për t'u konvertuar në ritin latin (e jo në atë bizantin të parashikuar) nuk qenka pranuar nga autoriteti i Propagandës, duke iu përbajtur kështu kushteve të betimit të dikurshëm.

Emrin e Gjergjit do ta ndeshim ‘rastësisht’ edhe katër herë të tjera në katalogët vjetorë të viteve 1728, 1729, 1730 dhe 1731 (ASPF CP Coll. Urbano 5 20 fol. 52v; 161vv.; 362v.; 398v.), ku shënohet ndër të tjera se i takon rritit <greco-albanese><sup>10</sup> se ka filluar studimet e rregullta më 22 prill 1720 (më parë dëgjues: sh. më lart), se ndërkokë ishte përkatësisht në vitet X deri XIII të studimit në kollegj e që gjatë kësaj periudhe studion retorikë dhe filozofi. Në këta regjistra ndeshim si komilitonë të tij edhe tre rishtarë shqiptarë të rritit latin: <Antonio Albanese>, <Antonio di Michele> dhe <Antonio Logorezzi> nga Shkodra. (sh. Demiraj 2017 113v.)

---

ky kushëri i tij i paska ngjarë vetëm nga shtati, me nuk ishte i prerë për atë të shkretë shkollë, andaj kërkoi e gjeti tjetër drejtim në jetë, bash si ushtar i zoti, bash ashtu siç na kumton regjistri i përgjithshëm si më poshtë: “A. Clemenete figlio di Anteblaui, e di As?a nato in Masmas, Prouincia di Goraghi è stato battezzato in S. Pietro essendo ancor Catecummeno dall’ emin.<sup>mo</sup> Sacrissante, e fù Compare il d.<sup>to</sup> P. Anibale Albani Nipote del Papa: è in età di anni dieci circa: [dora e dytë – B.D.] Partì di Collegio li 16 Nouembre 1704 . Licenziato per la sua incapacità e rizzezza nell’ apprendere quello che studiava: essendo di buona Corporatura, e robusto, facto & erbo cum sanctissimo, ha auuto una piazza di soldato in Castel Sant’ Angelo.” (ACU RNCAPF I 243)

<sup>9</sup> Pas gjase kemi të bëjmë me emrin e qytetit antik <Scleuia> në Siri, nga e ka marrë emrin edhe ipeshkëvia përkatëse.

<sup>10</sup> Për dallimet brenda rritit grek-bizantin, si me thënë për veçoritë e këtij riti brenda bashkësisë arbërishtfolëse në Sicili e gjekë ndërhyr për të parën herë me autorititin e tij vetë Gjergj Guxeta, i cili jo më kot e përzgjedh atë si njërin ndër identifikatorët kryesorë brenda matriksit të kulturës etnike të kësaj bashkësie. (sh. Demiraj 2015 40vv.; 2016 54vv.)

## 2. <Demetrius Camarda> (= /Dhimitër Kamarda/)

Emri i Camarda-s është sigurisht shumë i njohur në historinë e kulturës dhe të albanologjisë shqiptare si shkencë gjuhësore, ndërkokë që për rininë dhe formimin e tij intelektual-fetar në Romë të dhënët janë paksa të mangëta e jo rrallë edhe kundërthënëse.<sup>11</sup> Është kjo një arsyé më shumë për të lëçitur dokumentacionin arkivor në kolegj, meqë fiton rëndësi të veçantë. Nga materiali i shfletuar ashtu kalimthi, rezulton që edhe Camarda të ketë filluar dhe përfunduar studimet Kolegjin Urban. Emrin e tij e kemi fiksuar në dy katalogë (ACU CACV 1819-1837; CACV 1837), prej të cilëve mësojmë që Camarda ynë qenka siçilian (= <siculus>) i rtitit grek (= bizantin) në Dioqezën e Monreales (= <Montis Regalis>), paska lindur më 23 tetor 1821 e se ka hyrë në kolegj në moshën 10 vjeç më 10 dhjetor 1831. Aty ka bërë betimin më dt. 2 korrik 1841 dhe është liruar nga kolegji më 11 maj 1844 si <mission. in Patria>. Mund të fitojë dikur rëndësinë e vet edhe rrethi i komilitonëve shqiptarë të rtit latin që kryen studimet në kolegi përgjatë kësaj periudhe, ndër ta: Pal Dodmasi (= <Paulus Dodmassei>) nga Dioqeza e Shkodrës, Engjëll Babi (= <Angelus Babbis>), Gjon Suxhi (<Joannes Suggi>) e Mëhill Suma (<Michael Summa>) nga Dioqeza e Sapës, Ndue Mikeli (= <Antonio di Michele>) dhe Gjon Spathari (= <Joannes Spattari>) nga Dioqeza e Shkodrës etj. (sh. Demiraj 2017 139vv.).

## 3. <Vincentius Dorsa> (= it. <Vincenzo Dorsa>, shq. /Vinçenco Dorsa/)

Një përvojë deri diku të ngjashme, veçse në drejtim të përkundërt, me atë të Gjergj Matranga-s (nr. 1) mësojmë në skedën e regjistrat themelor (ACU RNCAPF II 308), si vijon:

“Dorsa Vincentius ortus 1823. 27. Febr in Oppido Frassineto  
Dicc. Cassanensis in Regno Neapolit. no ingressus 29.8.<sup>bris</sup> 1841 .  
Attulit testim. <sup>ia</sup>baptismatis Confirmat, <sup>is</sup> et Studiorum idest usque  
ad Philosophiam inclusire Est Ritus græci, et collet ling. alba-  
nensem . A.º 1842. stud. Theol. a.º I: Cum patri scripsisset se ali-  
quem lateris dolorem pati, illico Pater adhibito Doctoris Baräta  
Mediciæ [---] fessorum Patriarcæ filium reuocauit, et discessit

<sup>11</sup> I tillë është p.sh. informacioni i dhënë nga Raques (1983 50), sipas të cilit “Demetrio Camarda [...] entra nel Collegio di Propaganda Fide [= Collegio Urbano – B.D.] nel '31, pass al Collegio Greco nel '35, sacerdote il 25 aprile 1884 [...]. Sh. edhe (A.) Guzzetta 1983 7vv.

25. Martii Neapolim. Verior discedenti causa uidetur fuisse quod latine quidem intelligebat, sed cum nullum latine scribendi, et loquendi exercitium habuisset in S. Adriani Sem.<sup>o</sup> ubi omnia italice traduntur Scholis, ferre non potuit se non posse in Schola Theologiæ facile disserere in circulis etc.”

Regjistrimi i mësipërm na kumton ndër të tjera që Vincenco Dorsa lindi më 27 shkurt 1823 në Frascinetto (Ipeshkëvia e Cosenza-s) në Mbretërinë e Napolit. Në kolegj hyn më 29 tetor 1841, duke paraqitur edhe dëshmitë e pagëzimit, të konfirmacionit dhe studimet e tij në Kolegin e Shën Adrianit, duke përfshirë këtu edhe kurset e filozofisë. Është i rritit grek (= bizantin) dhe zotëron gjuhën shqipe. Në vitin 1842 fillon të studiojë teologji në vitin e parë. Sipas këshillës së mjekut u lirua nga kolegji për t'u kthyer në shtëpi më dt. 25 mars të po atij viti, menjëherë pasi i kishte shkruar papritur e pakujtuar të atit se paska dhimbje të forta në gjoks e se klima në Romë nuk qenka e pershatshme për shëndetligjtë. Veçse shkaku i vërtetë i largimit të tij fshihej gjetë: duket të ketë qenë shi latinishtja, të cilën në fakt e kuptonte, por ja që nuk e kishte praktikuar me shkrim e me gojë në Kolegin e Shën Adrianit në Shën Mitër, ku gjithçka zhvillohej në italisht.

Raste të tilla pranimi dhe largimi rishtarësh (edhe shqipfolës nga ky kolegj ase përgjithësisht sosh që nuk e donin atë të shkretë shkollë nuk janë të paka, madje i zbresin në tokë si mëkatarë të lindur edhe këto personalitete të kulturës shqiptare. Mjafton të kujtojmë azretin Fan S. Noli në autobiografinë e tij, ku shkruan me dorë të vet se si e fusnin në thes për ta çuar në shkollë, meqë s'e donte e s'e donte shkollën.

#### 4. <Philippus Matranga> (= it. <Filippo Matranga>, shq. /Filip Matrënga/<sup>12</sup>)

E kemi ndeshur këtë emër në dy katalogë, të cilët na kumtojnë si të dhëna të përgjithshme: vendlindjen në <Panormum> (Piana degli Albanesi ?) në Dioqezën e Monreale-s (: <Montis Regalis>), si i rritit grek (bizantin), i lindur më 6 tetor 1822 e që paska hyrë në kolegj më 31 mars 1841, duke bërë menjëherë betimin më dt. 2 korrik 1841. Pas formimit teologjik shugurohet prift dhe largohet nga kolegji në atdhe si misionar i Propaganda Fide-s më 8 mars 1848. Në këta regjistra ndeshim edhe ndonjë komiliton shqiptar prej dioqezës së Shkodrës, si p.sh. Ndue Shllakun (<Antonius Sclacu>), August Reçin (<Augustus Recci>) e ndonjë tjetër. (Demiraj 2017 140v.)

<sup>12</sup> ACU APCVPF MDCCCXLVIII.

### 5. <Joannes Baffa> (= it. <Giovanni Baffa>; shq. /Gjon Bafa/)

E ndeshim si komiliton të Matranga-s në të njëjtët katalogë, nga ku mësojmë ndër të tjera që të ketë lindur në <Bisinianum in Calabria> në dioqezën me të njëtin emër më 6 prill 1824, i rritit grek (= bizantin). Hyri në kolegj më 13 nëntor 1841, duke bërë betimin një vit më pas, shi më 8 dhjetor 1842. Pas formimit teologjik shugurohet prift dhe largohet nga kolegji në atdhe si misionar i Propaganda Fide-s më 1 qershori 1848.

### 6. <Caesar Martino> (= it. <Cesare Martino>)

Së bashku me Matranga-n dhe Baffa-n, Martino rezulton të jetë i treti i radhës, veçse e ndeshim vetëm në njërin katalog, ku mësojmë se ka lindur në Lungro të Kalabrisë si famulli e rritit grek(-bizantin) në Dioqezën e Cosenza-s (= <Cassanensis>) më 19 mars 1830. Në kolegj hyn më 10 nëntor të vitit 1842. Në vitin 1848 mësojmë të ketë studiuar retorikë, bashkë me shënimin e largimit nga kolegji (<dissessit>) më 19 korrik 1848. Vetëm kaq kemi shënuar për të.

### 7. <Franc[esco] Ant[onio] Tamburi><sup>13</sup>

Rishtar në kolegj, përparimin e të cilit nuk e kemi e kemi ndjekur nga afër, përpos shënimeve të mbajtura në një regjistër të vetëm (nr. 56), ku rezulton të jetë duke studiuar në kursin e lartë të gramatikës (= <gram. sup>). Tamburi si rishtar i rritit grek (-bizantin) paska lindur në Shën Vasil (<S. Basilius, Dioe. Cassanensis>) më 8 shkurt 1862, dhe paska hyrë në kolegj më 26 shkurt 1873.

### 8. <Nicolaus Schirò>

Në të njëjtin regjistër (nr. 96) me Francesco Tamburin ndeshim edhe rishtarin e ri të të njëjit rit nga Kundisa në Sicili (<Comitissa> = it. <Contessa Entelina>), i lindur më 3 maj 1863 e që ka hyrë në kolegj më 7 nëntor 1874, ku filloi të mësojë gramatikë në ciklin e ulët. Veçse nuk qëndroi gjatë, pasi – siç lexojmë në shënimet shtesë të bëra në katalog – më 16 janar të vitit në vazhdim u transferua në Kolegjin Grek.

<sup>13</sup> ACU APCVPF MDCCCLXXXVI.

\* \* \*

Mbyllim këtu këto ‘shënime’ të paplota për do rishtarë arbëreshë të ritit bizantin që studiuan ose kryen një pjesë të studimeve në Kolegjin Urban përgjatë periudhës së ashtuquajtur *Rilindje para Rilindjes*, parë kjo si periuadhë e parëleme e ende në shpërgënëj edhe për diskursin intelektual-shqiptar, por që nxiti rrjetëzimin e mendimit albanologjik ndërmjet rretheve të ndryshme intelektuale të shpërndara në ato vise ku flitej shqip. Sigurisht që ky diskurs nuk u zhvillua zanafilli në pulte akademike para një auditori sqimatar, por thjesht midis intelektualësh të formuar ase syresh në formim e sipër që kishin në damarë gjak shqiptari e si të tillë u hahej muhabeti, çka vjen me thënë kishin dëshirën të ndanin e të shkëmbenin dy fjalë me njëri-tjetrin, anipse në shkollë na shfaqen si tipa krejt të ndryshëm: nxënës të mbarë, të dëgjueshëm, inteligjentë, sikurse edhe sosh të paxënshëm ase ‘hileqarë’ që i kërkonin dhe i gjenin rrugëzgjidhjet qoftë për të hyrë në kolegj, qoftë për të dalë prej sish. E që ndër këta tipa kërkojmë e gjejmë herë pas here e rast pas rasti edhe ndonjë mëkëmbës të Bariut më të Parë, veçse me këmbë në tokë, është kjo një përsiatje e shëndetshme dhe e bazuar në fakte dokumentare, bash ashtu siç është mësuar të punojë e të përtypë Jubilari ynë. Ani, tash s’na mbetet tjetër, përpos të përsërisim fjalët e pararendësit të vet, me të cilat e hapëm edhe këtë shkrim: <Fallem nddersë t’Arbit, ggiacu’t culluam farëmirit>.

## Bibliografi e cituar

Altimari, Francesco

- 1984 Il movimento culturale della Rilindja e il Collegio di S. Adriano nella prima metà del secolo XIX, in: "Quaderni di Zjarri" 11 [1984]. Cosenza

Chetta, Nicolò (= Nikollë Keta)

- 1777 Tesoro di Notizie de' Macedoni. (1777 – ms.). Introduzione di Matteo Mandalà. Trascrizione di Giuseppa Fucarino; Contessa Entellina 2002.

Chiocchetta, Pietro

- 1971 La S. Congregazione e gli Italo-Greci in Italia, në: (Metzler, J. ed.) „Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. I/2, 1622-1700, Rom - Freiburg - Wien, f. 5-25.
- 1985 në: „Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. II, 1700-1815, Rom - Freiburg - Wien 1973, f. 555-576.

Demiraj, Bardhyl

- 2015 Studi filologici arbërescë, Marzi (Cosenza).
- 2016 Gjak i shprishur, Tiranë.
- 2017 Areali Kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX, Tiranë.

Fortino, Italo Costante

- 1985 Funzione dei seminari di rito Greco di Calabria e di Sicilia nella formazione del laicato Italo-Albanese, në: "Oriente Cristiano" Anno XXV, nr. 2-3 (Aprile - Settembre), f. 54-76.

Guzzetta, Antonino

- 1983 Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista; në: "Atti dell'XI Congresso Internazionale di Studi Albanesi", Palermo 22-22 Aprile 1983 7-19.

Jezernik, Maksimiljan

- 1971 Il Collegio Urbano, në: Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. I/1, 1622-1700, Rom - Freiburg - Wien 1971, f. 465-482.
- 1972 Il Collegio Urbano, në: Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. II, 1700-1815, Rom - Freiburg - Wien 1973, f. 283-299.

- 1975 Collegio Urbano, në: *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide Memoria Rerum. 350 Anni a servizio delle missioni. 1622-1972, vol. III/1, 1815-1972*, Rom - Freiburg - Wien 1975, f. 99-123.

**Mandalà, Matteo**

- 1994 La lettera inedita (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Guzzetta, in: “*βίβλος*” f. 4-10.
- 2002 Sh. lart Chetta, Nicolò 1777.

**Perri, Vitorio**

- 1970 Inizi e finalità ecumeniche del Collegio Greco in Roma, në: “*Aevum*” nr. 44 44, f. 1-72.
- 1985 L’ideale unionistico di p. Giorgio Guzzetta - La pace da ristabilire tra la Chiesa Greca e la Chiesa Romana, në: “*Oriente Cristiano*” Anno XXV, nr. 2-3 (Aprile - Settembre), f. 18-41.

**Raquez, Oliverio**

- 1985 Contributo del Collegio Greco di Roma alla formazione culturale-religiosa delle Colonie Italo-Albanesi di Sicilia, në: “*Oriente Cristiano*” Anno XXV, nr. 2-3 (Aprile - Settembre), f. 42-53.

**Sciambra, Matteo**

- 1967 Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese, në: “*Shëjzat (le plejade)*” 11 [1967] (1-4) 134-156, 281-301, 393-434.